SHTOJCA 2

**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**

PROJEKT-PROPOZIM PËR HAPJE/RIORGANIZIM/MBYLLJE PROGRAMI STUDIMI

1. Institucioni/IAL

**Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"**

2. Aplikimi (zgjidh një):

Program i ri ____X_
Riorganizim programi _____

3. Emërtimi i programit të propozuar për hapje/riorganizim

**Doktoraturë në " Ekonomi dhe Turizëm të Qëndrueshëm"**

4. Semestri dhe viti akademik i hapjes: **Semestri i parë i vitit akademik 2020-2021**

5. Të dhënat për aktin e hapjes/akreditimit të IAL dhe/ose njësisë kryesore që ofron programin e studimit.

6. Vendimi i miratimit nga Senati Akademik

**Vendimi i SA Nr.31 datë 22.01.2020 nr.274 prot.**

Vendimi i miratimit nga Bordi Administrim

**Vendimi i BA nr.38 datë 24.01.2020**

7. Nëse është një program i përbashkët studimi identifiko IAL-të bashkëpunuese dhe cito aktin e bashkëpunimit mes IAL-ve dhe marrëveshjen specifike për realizimin e programit të studimit.

Programi i Doktoraturës "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm" do të realizohet në kuadër të projektit ERASMUS + me titull "Reformimi i studimeve doktorale ne Mal te Zi dhe Shqiperi – paradigma e praktikes se mire" me numër **598465-EPP-1-2018-1-ME-EPPKA2-CBHE-SP**, dhe Marrëveshja nr. 210 prot. datë 21.01.2019 që Universiteti i Shkodrës ka nënëshkruar me Universitetin e Malit të Zi që synon hapjen e këtij programi në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Shkodrës. Partnerë në këtë projekt janë: nga BE (5 partnerë): Universiteti i Vjenës, Universiteti i Zagrebit, Universiteti i Mariborit, Universiteti i Banska Bistricës, Shoqata e profesionistëve të arsimit të doktoraturës; nga Ballkani Perëndimor Mali i Zi (5 partnerë): Universiteti i Malit të Zi, Universiteti i Donja Goricës, Ministria e Arsimit të Malit të Zi, Ministria e Shkencës e Malit të Zi, Dhoma e Tregtisë e Malit të Zi; nga Shqipëria (6 partnerë): Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti i Vlorës, Universiteti Metropolitan Tiranë, Ministria e Edukimit, Sportit dhe Rinisë të Shqipërisë, Dhoma e Tregtisë Shqiptare .Kohëzgjatja e këtij projekti është 3 vjet: nëntor 2018-tetor 2021. Programi i doktoraturës do të vazhojë të mbështetet financiarisht dhe me burime njerëzore në dy vitet e tjera

2021-2023 nga fondet e UNISHK, mbështetja financiare e bizneseve mbi bazën e marrëveshjeve, tarifat e studentëve pjesëmarrës në këtë program si dhe aplikimet në grantet qeveritare.

**8. Programi ofrohet nga/në:**

**Departamenti i Turizmit**_________________________________________
**Fakulteti i Ekonomise**______________________________________________
Kampusi/godina: **Godina e Re e Fakultetit Ekonomik, USH**____________________________

**9. Të dhëna mbi personat e kontaktit përgjegjës për programin e studimit:**

Emër, mbiemër: Brilanda Bushati
Pozicioni në IAL: Përgjegjëse e Departamentit të Turizmit
Tel: 0672784924
E-mail: brilanda.bushati@unishk.edu.al

10. **Deklaratë e titullarit të IAL për plotësimin e standardeve akademike dhe infrastrukturore, të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.**

Deklaroj që të gjitha të dhënat në këtë formular janë në përmbushje të plotë të standarteve akademike dhe standarteve shtetërore në mbështetje të të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**AUTODEKLARIM**

Ne/Unë i/ e nënshkruari/a Prof. Dr. Adem Bekteshi Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

1. Të gjitha të dhënat janë të vërteta dhe jam i vetëdijshëm për përgjegjësinë penale në rast dhënie informacioni të pavërtetë, si dhe pranoj, t'i nënshtrohem verifikimit nga organet përkatëse për të gjithë informacionin e paraqitur si më sipër.
2. IAL – ja është e rregjistruar në QKB si person juridik, me të drejtën e ushtrimit të aktivitetit në fushën përkatëse të arsimit, si më poshtë:

   Subjekti juridik përgjegjës për IAL në: Universiteti i Shkodrës, Fakulteti Ekonomik.
3. Subjekti juridik nuk disponon vërtetim pronësie nga zyra e rregjistrimit të pasurive të paluajtshme, por disponon akt përdorimi me VKM.
4. Qeraje me kohëzgjatje jo më pak se tre vite akademike nga momenti i paraqitjes së kësaj kërkese.
5. Deklaroj se subjekti juridik disponon mjedis të përshatshëm për realizimin e procesit mësimor bazën materiale të nevojshme sipas standartave shtetërore në fuqi.
6. Deklaroj se subjekti juridik ka krijuar kushte për studentët me aftësi të kufizuara

në mjediset ku ushtrohet veprimtaria e mësimdhënies.

7. Subjekti juridik dhe personat përgjegjës për administrimin e tij nuk janë në proces gjykimi; hetimi si dhe nuk rezultojnë të dënuar në fushën që kërkohet të ushtrohet aktiviteti.
8. Deklaroj se subjekti plotëson të gjitha standartet akademike dhe shtetërore sipas kuadrit ligjor në fuqi.
9. Deklaroj se subjekti juridik plotëson të gjitha standartet infrastrukturore shtetërore sipas kuadrit ligjor në fuqi.
10. Deklaroj se subjekti juridik nuk rezulton debitor ndaj organeve tatimore në nivel qendror dhe vendor për të gjitha llojet e detyrimeve përfshirë energjinë elektrike dhe furnizimin me ujë.
11. Deklaroj se subjekti juridik disponon lejen Higjieno – Sanitare për cdo mjedis ku do të zhvillohet veprimtaria dhe aktin për mbrojtjen kundër zjarrit, brenda afateve të vlefshmërisë.
12. Deklaroj se subjekti juridik disponon vlerat monetare për financimin e programit përkatës të studimit dhe është përgjegjës ndaj studentëve për mos respektimin e kontratave të lidhura

11. **Firma (emër / mbiemër) e titullarit të institucionit dhe vula e institucionit**

Prof. ... Ferlu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI" SHKODËR

**PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË PROPOZUAR PËR HAPJE/RIORGANIZIM**
**a) Të dhëna mbi programin e studimit:**

**Në këtë seksion duhet të përfshihen të dhëna mbi elementët e mëposhtëm:**
**- Lloji i programit.**
Doktoraturë në "Ekonomi dhe Turizëm të Qëndrueshëm"

**- Njësia bazë / njësia kryesore ofruese e programit të studimit.**
Departamenti i Turizmit, Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

**- Arsyetimi për nevojën e hapjes së programit (risia që sjell ky program).**
Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Shkodrës mbështet kërkesën për hapjen e programit të studimeve të doktoraturës në fushën e "Ekonomi dhe Zhvillim i Turizmit të Qëndrueshëm" duke u bazuar në oportunitetin që u krijua në kuadër të projektit ERASMUS + me titull "Reformimi i studimeve doktorale ne Mal te Zi dhe Shqiperi – paradigma e praktikes se mire" me numër **598465 EPP 1 2018 1 ME EPPKA2 CBHE SP**, Marrëveshja nr. 210 prot. date 21.01.2019 që Universiteti i Shkodrës ka nënëshkruar me Universitetin e Malit të Zi që synon hapjen e këtij programi në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Shkodrës. Rijsia e këtij programi është fusha në të cilën do të përqëndrohet kërkimi shkencor siç është Turizmi i Qëndrueshëm duke qenë në një linjë me prioritetin aktual global të ndjeshmërisë ndaj cështjeve të klimës dhe respektimit të natyrës e vlerave kulturore të një vendi. Tjetër rijsi që sjell ky program doktorature është bashkëpunim me Unviersitetet Perëndimore partnere në projektin Erasmus + MARDS që sjellin eksportizën më të mirë të programev të ngjashme përfituar nga trajnimi i stafeve akademike të UNISHK gjatë vitit të parë të projektit. Gjithashtu në këtë program një theks i veçantë do i vendoset bashkëpunimit mes studentëve doktorantë dhe bizneseve të Rajonit të Shkodrës ku nëpërmjet marrëveshjeve të nënshkruara me keto biznese ashtu si edhe me Bashkimin e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë do të orientohet kërkimi shkencor në funksion të zgjidhjes së sfidave dhe të aplikimit të inovacioneve në fushën e turizmit të qëndrueshëm. Në kuadër të projektit MARDS u kryen dy raporte si më poshtë:
1."Raporti i situatës së arsimit doktoral në Mal të Zi dhe Shqipëri në krahasim me praktikat e BE" me autorë: Melita Kovacevic,Vesna Cavic ( Universiteti i Zagrebit) dhe Luzas Zinner ( Universiteti i Vjenës)
2. Raport mbi financimin e studimeve doktorale në Mal të Zi dhe Shqipëri me autor Prof. Predrag Miranovic.
https://www.mards.ucg.ac.me/docs/MARDS%20A3.1%20Questionnaire.docx
Fakulteti Ekonomik i Universiteti të Shkodrës që nga viti 2008 ofron 4 programet e Masterit Shkencor në profilin e Turizmit të Qëndrueshëm (2008), Administrim-Biznesit (2011), Financës (2011) dhe Kontabilitetit (2011) duke sjellë nevojën për ofrimin e ciklit të tretë të studimeve për 439 studentët që janë diplomuar në këto 4 programe te Masterave Shkencorë që nga viti 2015. Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" duke qenë i vetmi në Rajonin e Veriut të Shqipërisë dhe i dyti për nga vjetërsia pas Universitetit të Tiranës ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe emancipimin e këtij Rajoni. Dhe ne këtë kuadër edhe Fakulteti Ekonomik i hapur që në vitin 1993 ka kontribuar me studime, punime konkrete praktike, me personel të kualifikuar në zhvillimin ekonomik dhe në përmirësimin e jetës së komunitetit të

Rajonit të Veriut të Shqipërisë. Duhet theksuar se gjatë periudhës 1993 – 2019 nga Fakulteti Ekonomik i U.Sh. janë diplomuar 4182 studentë nga të cilët 3920 në sistemin me kohë të plotë dhe 262 në sistemin me kohë të pjesshme. Studentët tanë janë punësuar në Universitete, Bashki, Prefektura, Qarqe, Dhoma Tregtie dhe bizneset private kryesisht të Rajonit të Shkodrës por jo vetëm. Duhet theksuar se rreth 35 % e studentëve të diplomuar kanë përfunduar studimet e tyre me një mesatarë të studimeve mbi 8 ku studentët e tre degëve (Financë-Kontabilitet, Adminsitrim-Biznes dhe Turizem) janë ndër më cilësorët nga Fakultete e tjera të USH. Nga ky aspekt kërkesat e tyre për kualifikim të metejshëm janë në rritje të vazhdueshme duke parë edhe vështirësitë që iu janë krijuar atyre disa herë në rrugën e kualifikimit në Universitetet e tjera shqiptare apo jashtë vendit. Për më tepër bizneset e rajonit të Shkodrës kanë shtuar gjithnjë e më tepër kërkesat për të punësuar staf cilësor e sidomos rreth 20 banka të huaja dhe shqiptare që janë hapur në qytetin e Shkodrës si dhe 3 hotele te mëdha (Hotel Rozafa, Hotel Grad Europa dhe Hotel Colosseo) me 4 dhe 5 yje si dhe rreth 154 biznese të vogla dhe të mesme (bar-restorante, bujtina, agjensi turistike, organizata jofitimprurese me fokus turizmin) që i përkasin Rajonit të Shkodrës kanë kritere të kualifikimit të larta dhe kërkesa për lidhje të ngushta me Institucionet akademike.

Gjithahshtu rëndësia e hapjes së programit të doktoraturës në Ekonomi dhe Turizëm të Qëndrueshëm në Fakultetin Ekonomi të UNISHK lidhet me prioritetin që Qeveria Shqiptare i ka vene sektorit te Turizmit duke mbështetur me fonde dhe duke tërheqe edhe investimet e huaja ne drejtim të kesaj shtylle te ekonomise sonë. Në këtë aspekt ne shpresojmë që nëpërmjet projekteve kërkimore që do prezantohen për mbështetje financiare tek AKKSHI të sigurojmë kërkime cilësore që lidhen me zhvillimet ekonomike të evendit e nëmnyrë të çantë turizmin si sektor prioritar.

Për më tepër që nga viti 2009 – 2010 në kuadrin e disa projekteve të vogla me orientim praktik të mbështetur nga Konferenca e Rektorëve Gjermanë u hap Masteri Shkencor ne Turizëm të Qëndrueshëm që kontribuon ndaj këtij sektori me studentë të kualifikuar me pregatitje teorike dhe praktike. Po kështu Fakulteti Ekonomik është i përfshirë në mënyrë intensive dhe të vazhdueshme në projekte me mbështetje financiare nga BE ku kanë marrë pjesë në aktiviteteve kërkimore dhe shkencore stafet akademike dhe studentët.

Vlen të theksohet projekti i fundit në kuadër të skemës së financimit INTERREG me titull" Fostering tourism innovation system in Adriatic-Ionian Region -FOST INNO" (Nxitja e sistemit të inovacionit të turizmit në rajonin Adriatikut – Jonit ) me kohëzgjatje periudhën 2018 – 2020. Qëllimi i projektit INTERREG ADRION "FOST INNO" me partner Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Shkodrës, dhe që vijon zbatimin ishte të krijonte një bazë shkencore për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe për të vendosur një rrjet të organizuar të aktorëve që do të kordinojë dhe do t'i japë një mbështetje afatgjatë zhvillimit të inovacioneve në Rajonin Adriatiko-Jonian.

Objektivi kryesor i projektit ishte zhvillimi i Strategjisë për Nxitjen e Inovacioneve në Turizmin e Qëndrueshëm dhe Planet e Veprimit për zbatimin e kësaj strategjie në Rajonin Adriatiko-Jonian ku Fakulteti Ekonomik ishte i vetmi partner përfaqës për Shqipërinë dhe kotribuoj me punën shkencore të stafit duke sjellë modelet më të mira të zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm nga Veriu i Shqipërisë.

Një objektiv tjetër i rëndësishëm i këtij projekti ishte krijimi i Qendrës së Inovacionit në Turizëm që do të promovojë inovacionet në sektorin e turizmit duke realizuar trajnime dhe mbeshtetje me ekspertize akademike bizneset turistike ku në Fakultetin Ekonomik u krijua pika e kontaktit për këtë qendër duke zhvilluar edhe aktivitetet e para si trajnime për bizneset, e-konsultime duke percaktuar dhe kriteret dhe standartet qe duhet te ndjekin inovacionet e bizneseve ne Rajonin e Veriut te Shqiperise.

Marrëveshjet me bizneset që u kryen në kuadër të projektit FOST INNO janë përfshirë si pjesë e dosjes së këtij aplikimi.

Po kështu duhet të theksohet se çdo vit kemi rritje të kërkesave të pedagogëve të brendshëm dhe studentëve cilësore që përfundojnë 4 Masterat Shkencorë të Fakultetit Ekonomik për të vazhduar studimet e doktoraturës prandaj hapja e këtyre studimeve në U.Sh. do t'i lehtësontë punën e tyre së tepërmi dhe do të ndihmonte në rritjen dhe zhvillimin e vetë Fakultetit Ekonomik të U.Sh me staf të kualifikuar.

**- Përshkrimi i përgjithshëm i programit, misioni, qëllimi dhe objektivat e tij.**

## Misioni i programit

Programi i Doktoraturës në Ekonomi e Turizëm të Qëndrueshëm që do ofrohet në Fakultetin Ekonomik te Universitetit te Shkodres do të formojë kërkues të një kualifikimi të lartë në fushën e menexhimit dhe zhvillimit inovativ të bizneseve turistike.

Programi do iu ofrojë kandidateve mundësinë për të thelluar dhe zhvilluar njohuritë teorike dhe metodologjike dhe për të prodhuar një kontribut të një kërkimi origjinal.

## Qëllimi

Qëllimi i këtij programi doktoraturë do të jetë të pregatisë specialistë të kualifikuar për të kontribuar në zhvillimin e turizmit të qëndueshëm në Shqipëri e në veçanti në Rajonin e Veriut ku turizmi si një sektor prioritar i zhvillimit ekonomik do të eksplorohet dhe zhvillohet më tej në mënyrë shkencore dhe innovative.

Duke u orientuar nga cilësia dhe standarte të forta të ekselencës studentët e doktoraturës do të kenë oportunitetin që të jenë në kontakt të drejtpërdrejtë me punëdhënësit në sektorët strategjik të ekonomisë së vendit dhe rajonit për të fituar prej tyre ide në karierën potenciale dhe mundësitë brenda këtyre organizatave.

Përfaqësuesit e industrisë dhe biznesit gjithashtu do kenë mundësinë për të kërkuar prej studentëve potencial që do tí përshtaten zhvillimeve të ardhshme të organizatave të tyre respektive.

## Objektivat

Objektivat e këtij programi do jenë:

a) Të kontribuojë me kërkim shkencor të thelluar në funksion të bizneseve të vogla dhe të mesme për tí shërbyer zhvillimit të inovacioneve dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve turistike.
b) Të forcojë lidhjet midis biznesit dhe universitetit duke e orientuar kërkimin shkencor nga zhvillimet ekonomike dhe prioritete strategjike të vendit sic është sektori i turizmit
c) Të ofrojë udhëheqje të fokusuar në zhvillimin dhe eksplorimin e ideve të reja me orientim në krijimin e lidhjeve dhe rrjeteve midis biznesit dhe akademisë.

d) Të shërbejë si një model ku kërkimi shkencor kryhet në funksion të zhvillimeve aktuale të vendit dhe duke qenë i dobishëm në rijsitë e eksploruara të justifikojë edhe burimet e financimit që e mbështesin atë.

**b) Të dhëna mbi kriteret e pranimit në këtë program studimi, tarifa dhe modalitet financiare për studentët:**

**Në këtë seksion duhet të përfshihen të dhëna mbi elementët e mëposhtëm:**
**- Kriteret e pranimit në programin e studimit.**

Në programin e doktoraturës" Ekonomi dhe Turizëm të Qëndrueshëm" do të pranohen kandidatët që kanë kryer Master Shkencor me mesatare të studimeve 8 e sipër.

Kriteret bazë që duhet të plotësojë kandidati për para mbrojtjes së tezës së disertacionit janë:

a) Të ketë realizuar si autor i parë ose i dytë, kur autori i parë është udhëheqësi shkencor, së paku 3 ( tre) referime, 2 ( dy) nga të cilat të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare ( simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Europian, OECD-së ose G20 ës, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara ne "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN;
b) Të ketë botuar, së paku, 3 ( tre) artikuj shkencorë në revista shkencore, nga të cilat 2 ( dy) të jenë botuar ose pranuar për botim në revista të indeksuara të vendeve të OECD-se dhe BE-se ose G20 -es, me bord editorial ku së paku në njërin prej tyre të jetë autor I parë dhe tjetrin autor i dytë.

**- Fusha e studimeve paraardhëse (në rastet e programeve të ciklit të dytë).**

-

**- Numri maksimal i studentëve që do të pranohen.**

20 studentë

**- Dokumentacioni i aplikimit.**

**- Tarifa e studimit.**

300 000 leke gjatë 3 viteve

Plani financiar i programit të studimit:

| **Financimet (Hyrjet)** | | |
|---|---|---|
| **Nr I studentëve** | **Tarifa për:** | **Totali** |
| **10 minimumi 20 maksimumi** | **Rregjistrim 3000 leke** | **30 000 – 60 000** |
| **10 minimumi 20 maksimumi** | **Shkollim 300 000 leke** | **3 000 000 – 6 000 000** |
| **Totali 3 030 000 - 6 060 000** | | |

Tarifa e studimit të këtij cikël studimi është përllogaritur duke marrë parasysh shpenzimet e domosdoshme që do nevojiten për ofrimin e këtij shërbimi, nivelin e përgjithshëm ekonomik të studentëve që frekuentojnë Universitetin Luigj Gurakuqi Shkoder, si dhe duke marrë parasysh edhe nivelin e tarifave të programeve të tjera të ciklit të trete në Universitetin e Shkodrës dhe ne Universitetet e tjera shteterore që ofrojnë programe te ngjashme.

Tarifa e rregjistrimit paguhet përpara konkursit dhe pagesa bëhet zakonisht me postë (sipas udhëzimeve të MAS). Ndërsa tarifa e shkollimit bëhet përpara fillimit të vitit akademik përkatës dhe zakonisht bëhet me bankë (sipas udhëzimeve të MAS)

| **Kostot e menaxhimit (daljet)** | |
|---|---|
| Shpenzime për **material didaktike, kancelari, bibliografike** | 200 000 – 1 200 000 |
| Blerje materialesh te invetarizueshme | 300 000 – 1 600 000 |
| Shpenzime per promovimin e programit | 100 000 – 500 000 |
| Shpenzime te tjera | 30 000 – 480 000 |
| Totali | 630 000 – 3 780 000 |

**- Politika e mbështetjes financiare për studentët (llojet e bursave nëse ka).**

Projekti Erasmus + "MARDS" do të mbështesë pjesë të praktikës pranë Universiteteve Perëndimore që janë partnerë të këtij projekti. Po kështu mbi bazën e marrëveshjeve të USH me bizneset do të sigurohen bursa në mbështetjen të studentëve të doktoraturës. Gjithashtu USH do të mbështesë studentët e programit të doktoraturës që do jenë pjesë e stafit akademik me kohë të plotë apo me kohë të pjesshme. Gjithashtu një mbështetje financiare do të sigurohet nga aplikimi tek grantet qeveritare (AKKSHI).

**- Kuota të dedikuara për studentët të kategorive të veçanta.**

**c ) Plani mësimor/Kurikula e programit të studimit**
**Ky seksion duhet të paraqes një analizë të detajuar të kurrikulës së programit referuar në Standardeve Shtetërore të Cilësisë dhe kërkesave ligjore në fuqi, duke ju përgjigjur elementëve të mëposhtëm:**

**- Numri total i krediteve;**

180 kredite (60 kredite per secilin vit nga 3 vite në total)

- Pasqyrë analitike (për lëndë e module) e kurikulës dhe krediteve si më poshtë:
- o Lëndë të përgjithshme;
- o Lëndë karakterizuese;
- o Lëndë ndërdisiplinore/karakterizuese ;
- o Lëndë plotësuese.

- Praktika profesionale.
- Detyrime përmbyllëse
- Tema e diplomës/provimi i përgjithshëm përfundimtar.

**Struktura e programit të doktoraturës në Ekonomi dhe Turizëm të Qëndrueshëm**

| | **VITI I** | | |
|---|---|---|---|
| **LËNDË TË DETYRUARA** | **Semestri i parë** | | |
| **Tipi i veprimtarisë dhe simboli përcaktues për të** | **Fushat e kërkimit shkencor dhe formimi i thelluar teorik** | **Kredite** | **Totali i krediteve** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Të përgjithshme (bazë) (Simboli A) | Planifikimi strategjik i avancuar i destinacioneve turistike (Universiteti i Shkodrës, Universiteti i Vlorës, Sandhills Community College, SHBA, Universiteti i Mariborit)) | 7 | 7 |
| | Menexhimi i turizmit të qëndrueshëm (Universiteti i Shkodres, Universiteti i Vlorës, Sandhills Community College, SHBA) | 9 | 9 |
| Veprimtari në disiplina karakterizuese të programit të studimit (Simboli B) | Ekonomiksi i Zhvillimit të qëndrueshëm (Universitetii i Mariborit, Universiteti i Shkodrës) | 7 | 14 |
| | Metodat e avancuara të kërkimit (Universiteti i Malit të Zi, Universiteti i Shkodrës, Universiteti i Vlorës, Universiteti i Gonzagës, SHBA, Universiteti Metropolitan i Tiranes) | 7 | |
| **Totali i krediteve Semestri i parë** | | | 30 |
| **LËNDË ME ZGJEDHJE** | **Semestri i dytë** | | |
| Veprimtari në disiplina me zgjedhje të studentit, ndër disiplinat e ofruara nga institucioni (simboli D)<br>**4 lëndë me zgjedhje** | Ruajtja dhe menexhimi i biodiversitetit (Universiteti i Shkodrës, Universiteti i Mariborit) | 9 | 9 |
| | Menexhimi i projekteve (Universiteti i Shkodrës) | 7 | 7 |
| | Sistemet e informimit ne turizëm (Universiteti i Shkodrës, Universiteti Metropolitan i Tiranës) | 7 | 7 |
| | Sipërmarrja sociale dhe inovacioni (Universiteti i Shkodrës) | 7 | 7 |
| Veprimtari të ngjashme ose integruese (simboli C) | Ekonomiksi i ambjentit ne Turizem (Universiteti i Malit të Zi) | 7 | 7 |
| | Vizualizimi i të dhënave dhe analiza në turizëm dhe planifikimin e rekreacioneve (Universiteti i Malit të Zi) | 7 | 7 |
| | Elementët e Matematikës për Ekonomiksin (Universiteti i Malit të Zi) | 7 | 7 |
| | Turizmi detar (Universiteti i Vlorës) | 7 | 7 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Turizmi i verdhë (Universiteti i Vlorës) | 7 | 7 |
| | Restaurimi i Qendrave Urbane dhe i peisazhit historik (Universiteti Politeknik i Tiranes) | 7 | 7 |
| | Rikuperimi Rijetëzimi i Monumenteve (Universiteti Politeknik i Tiranës) | 7 | 7 |
| | Menexhimi i pasurisë kulturore (Universiteti Politeknik i Tiranës) | 7 | 7 |
| | Marrëdhëniet publike dhe media digjitale ( Universiteti i Mariborit) | 7 | 7 |
| | Diskursi në Turizëm (Universiteti i Mariborit) | 7 | 7 |
| | Menexhimi i kanalit të shpërndarjes në mikpritje (Universiteti Metropolitan) | 7 | 7 |
| | E CRM,e commerce (Universiteti Metropolitan) | 7 | 7 |
| **Totali i krediteve Semestri i dytë** | | | 30 ECTS |
| **TOTALI I KREDITEVE VITI I PARE** | | | 60 ECTS |
| | **Viti i dytë** | | |
| | **Semestri i tretë** | | |
| Njohuri të tjera formuese, si plotësime, gjuhë e huaj, informatikë, prezantuese, stazh apo praktika, etj (simboli E) | Praktika 3 mujore jashtë shteti pranë Universiteteve partnere ose pranë një biznesi. | 30 | 30 |
| | **Semestri i katërt**<br>Zhvillimi i projektit kërkimor dhe puna kërkimore shkencore pranë bizneseve për tezën e desertacionit | 30 | 30 |
| **TOTALI I KREDITEVE VITI I DYTË** | | | 60 ECTS |
| | **Semestri i pestë** | | |
| Teza e disertacionit (simboli F) | Zhvillimi i kërkimit shkencor në funksion të pregatitjes dhe prezantimit të tezës së disertacionit në nivel Departamenti dhe nivel Fakulteti | 30 | 30 |
| | Zhvillimi final i tezes, pregatitja dhe prezantimi publik i tezës së desertacionit | 30 | 30 |
| **TOTALI I KREDITEVE VITI I TRETË** | | | 60 ECTS |
| **TOTALI I KREDITEVE** | | | **180** |

**c) Personeli akademik dhe ndihmës akademik**

**Në këtë seksion shtjellohet një përmbledhje e shkurtër mbi personelin akademik dhe ndihmës akademik të përfshirë me programin e studimit, duke përfshirë informacion mbi:**

- Numri i personelit akademik në njësinë bazë.

Në Departamentin e Turizmit të Fakultetit Eonomisë së Universiteti të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" me një histori 14 vjeçare janë të angazhuar aktualisht pedagogët e mëposhtëm:

1. Prof.as.dr.Brilanda Bushati Përgjegjëse e Departamentit
2. Prof.dr.Arjeta Troshani
3. Prof.as.dr.Mirjam Dibra
4. Dr.Alkida Hasaj
5. Dr Romina Dhora
6. Dr. Rudin Beka
7. Arjan Gjuraj,MSc
8. Sead Baraku,MSC

- Numri i personelit akademik që i dedikohen programit të studimit (personel efektiv dhe jo efektiv).

Personel efektiv nga Fakulteti Ekonomik:

1. Prof.dr.Arjeta Troshani
2. Prof.dr.Elez Osmani
3. Prof.dr.Fatbardha Molla
4. Prof.as.dr.Blerta Dragusha
5. Prof.as.dr.Albana Begani
6. Prof.as.dr.Elidiana Bashi
7. Prof.as.dr.Ardita Boriçi
8. Prof.as.dr.Brilanda Bushati
9. Prof.as.dr.Mirjam Dibra
10. Prof.as.dr.Ermira Kalaj

Personel joefektiv qe do te angazohet ne kuader te projektit Eramsus+ MARDS dhe marreveshjeve te tjera qe UNISHK ka me Universitetet partnere.

1. Prof.dr.Radovan Stojanovic- Universiteti i Malit të Zi
2. Prof.dr.Djurdica Pejovic – Universiteti i Malit të Zi
3. Prof.dr.David Kalaj – Universiteti i Malit të Zi
4. Prof.dr.Goran Popivoda – Universiteti i Malit të Zi
5. Prof.as.dr.Sanja Pekovic -Universiteti i Malit të Zi
6. Prof.as.dr.Jasna Potocnik – Universiteti i Mariborit
7. Prof.dr.Marko Koscak – Universiteti i Mariborit
8. Prof.as.dr.Mirjeta Beqiri – Universiteti i Gonzagës, SHBA
9. Prof.dr.Ted Oelfke – Kolegji i Sandhills, SHBA
10. Prof.dr.Victoria Collins – Kolegji i Sandhills, SHBA
11. Prof.as.dr.Kirk Lynch – Kolegji I Sandhills, SHBA
12. Prof.dr.Florian Nepravishta- Universiteti Politeknik i Tiranës
13. Prof.as.dr.Armand Vokshi – Universiteti Politeknik i Tiranës
14. Prof.as.dr.Elfrida Aliu – Universiteti Politeknik i Tiranës
15. Prof.dr.Betim Cico – Universiteti Metropolitan i Tiranës
16. Prof.dr.Ahmet Ceni – Universiteti Metropolitan i Tiranës
17. Prof.as.dr.Ozcan Asilkan – Universiteti Metropolitan i Tiranës
18. Prof.as.dr.Kristofor Lapa – Universiteti i Vlorës
19. Prof.as.dr.Elenica Pjero – Unversiteti i Vlorës
20. Prof.as.dr.Elona Proko – Universiteti i Vlorës
21. Dr.Enkeljd Mehilli (PhD ne Greqi) – Universiteti i Vlorës
22. Dr.Elton Domnori (PhD Itali) – Universiteti Metropolitan i Tiranës

**- Numri i personelit akademik të përfshirë në lëndët karakterizuese (personel efektiv dhe jo efektiv).**

**42 stafe akademike me titullin "Professor" dhe "Professor i asociuar "**(Lista e personelit efektiv ne Fakultetin Ekonomik + Lista e Personelit Joefektiv nga marreveshja e projektit Erasmus + MARDS dhe marreveshjet e tjera qe ka UNISHK + Lista e personelit akademik qe vjen nga Fakultetet e tjera të UNISHK

**-CV e shkurtuar (bio) e personelit akademik nga IAL, që do të angazhohet në program (titulli/grada, fusha e ekspertizës kërkimore), angazhimin në program të personaliteteve të spikatura të fushës së studimit, etj.**

| Personeli akademik | Titulli apo grada shkencore | Institucioni | Departamenti/ Qendra<br>Njësia kryesore | Fusha e ekspertizës kerkimore |
|---|---|---|---|---|
| 1. Arjeta Troshani | Prof. Dr. | Fakulteti Ekonomik, UNISHK | Dep. i Turizmit | Marketing turistik,Turizem i qendrueshem dhe trashegimi kulturore |
| 2. Brilanda Bushati | Prof. As. Dr | Fakulteti Ekonomik, UNISHK | Përgjegjës i Departamentit të Turizmit | Sisteme Informimi, Planifikim turizmi, Hoteleri-restoranteri |
| 3. Mirjam Dibra | Prof. As. Dr. | Fakulteti Ekonomik, UNISHK | Dep. i Turizmit | Zhvillimi i Turizmit te Qendrueshem, Trashegimi kulturore |
| 4. Blerta Dragusha | Prof.as.dr. | Fakulteti Ekonomik, UNISHK | Dekane e Fakultetit Ekonomik Dep. i Financë-Kontabilitetit | Menexhim Finanaciar. Drejtimi financiar i projekteve ne turizem |
| 5. Albana Boriçi | Prof.as.dr. | Fakulteti Ekonomik,UNISHK | Zv.Dekane e Fakultetit Ekonomik | Ekonomiks i spermarrjes sociale, ekonomiks nderkombetar |
| 6. Ardita Boriçi | Prof.as.dr. | Fakulteti Ekonomik, UNISHK | Dep. i Administrim-Biznesit | Ekonomiks, Matematike, Statistike, Metoda kerkimi |
| 7. Elldiana Bashi | Prof.as.dr. | Fakulteti Ekonomik, UNISHK | Përgjegjes i Departamentit te Finance Kontabilitetit | Finance, Menexhim Projektesh |
| 8. Elez Osmani | Prof.dr. AKADEMIK | Fakulteti Ekonomik, UNISHK | Dep. i Finance-Kontabilitetit | Menexhim Projektesh, Financa |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 9. Ermira Kalaj | Prof.as.dr. | Fakulteti Ekonomik, UNISHK | Dep. i Finance-Kontabilitet | Ekonomiksi i |
| 10. Fatbardha Molla | Prof.dr. | Fakulteti Ekonomik, UNISHK | Dep. i Finance-Kontabilitetit | Financë, Kontabilitet |
| 11. Adem Bekteshi | Prof.dr. | Fakulteti i Shkencave Natyrore, UNISHK | Rektor i UNSIHK, Departamenti i Bilogji-KImise | Kimi |
| 12. .Gezim Dibra | Prof.dr. | Fakulteti i Shkencave te Edukimit, UNISHK | Zv.Rektor i UNISHK, Departamenti i Psikologjise Sociale | Shkencat e Edukimit, Didaktike, Komuniki |
| 13. Anila Neziri | Prof.dr. | Fakulteti i Shkencave Natyrore, UNISHK | Departamenti i Biologji-Kimise | Kimi e ujerave, Menexhim biodiversiteti |
| 14. Marash Rakaj | Prof.as.dr. | Fakulteti i Shkencave Natyrore, UNISHK | Departamenti i Biologji-Kimise | Menexhim Biodiversiteti, Biologji |
| 15. Nevila Dibra | Prof as dr | Fakulteti i Shkencave Shoqerore, UNISHK | Departamenti i Gjeografise | Menexhim Biodiversiteti, Gjoegrafi e Turizmit |
| 16. .Entela Hoxhaj | Prof.as.dr. | Fakulteti Juridik,UNISHK | Departamenti i te Drejtes Publike | Jurridik, Ligje Biznesi |
| 17. Alma Hafizi | Prof.as.dr. | Fakulteti i Gjuheve te Huaja, UNISHK | Depratamenti i Italianistikes | Gjuhe e Huaj ne Turizem, Trashegimi Kulturore |
| 18. Dhurata Hoxha | Prof.as.dr. | Fakulteti i Gjuheve te Huaja, UNISHK | Departamenti i Italianistikes | Menexhimi i resurseve turistike |
| 19. .Edlira Bushati | Prof.as.dr. | Fakulteti i Gjuheve te Huaja, UNISHK | Pergjegjese e Departamenti te Gjermanistikes | Gjuhe e Huaj e aplikuar ne Turizem |
| 20. Meri Guli | Prof.as.dr. | Fakulteti i Gjuheve te Huaja, UNSHK | Deparatamenti i Anglistikes | Gjuhe e Huaj e aplikuar ne turizem |
| **Personeli akademik që do angazhohet në kuadër të projektit Erasmus+ MARDS dhe në kuadër të marrëveshjeve specifike që ka UNISHK me Universitetet të tjera partnere** | | | | |
| 21. Radovan Stojanovic | Prof.dr. | Fakulteti i Inxhinierise Elektrike, Universiteti i Malit te Zi | Qendra e Biteknologjise | Sisteme informimi, Informatike e aplikuar ne turizem dhe ekonomi |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 22. Djurdica Pejovic | Prof.dr. | Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Malit te Zi | Pergjegjese e Departamenti te Turizmit | Turizem i Qendrueshem |
| 23. David Kalaj | Prof.dr. | Fakulteti i Shkencave te Natyrës,Universiteti i Malit te Zi | Departamenti i Matematikes | Matematike e aplikuar ne Ekonomi |
| 24. Goran Popivoda | Prof.dr. | Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universitei i Malit te Zi | Departmenti i Matematikes | Matematike e palikuar ne ekonomi, Metoda kerkimi |
| 25. Sanja Pekovic | Prof.as.dr. | Universiteti i Malit te Zi | Pergjegjese e Institutit te Kerkimit dhe Inovacionit | Turizem i Qendrueshem |
| 26. Jasna Potocnik | Prof.as.dr. | Fakulteti i Turizmit, Universiteti i Mariborit | Departamenti i Turizmit | Turizem i Qendrueshem, Diskursi ne turizem dhe publiciteti ne turizem |
| 27. Marko Koscak | Prof.dr. | Fakulteti i Turizmit, Universiteti i Mariborit | Departamenti i Turizmit | Turizem i Qendrueshem, Ekonomiks Turizem |
| 28. Mirjeta Beqiri | Prof.as.dr. | Drejtore e Programit të Masterave ne Administrim-Biznes, Universiteti i Gonzges,SHBA | Drejtore e Programit të Masterave ne Administrim-Biznes | Drejtim Operacional, Metoda te Avancuara të Kërkimit |
| 29. Ted Oelfke | Prof.dr. | Departamenti i Turizmit, Kolegji i Sandhills, SHBA | Departamenti i Kulinarise dhe Turizmit | Turizem, Hoteleri, Restoranteri |
| 30. Viktoria Collins | Prof.dr. | Departamenti i Ligjeve, Kolegji i Snadhills, SHBA | Departamenti i Turizmit | Komunikim ne Biznes, Ligje ne Biznes |
| 31. Kirk Lynch | Prof.as.dr. | Fakulteti Ekonomik, Kolegji Sandhills,SHBA | Pergjegjes i Departamentit te Menexhimit dhe Teknologjive te Biznesit | Kontabilitet, Finance, Menexhim projektesh |
| 32. Florian Nepravishta- | Prof.dr. | Dekani i Fakultetit të Arkitektures dhe Urbanistikes Universiteti Politeknik i Tiranës | Departamenti i Arkitektures | Arkitekture ne turizem, restaurim monumentesh, menexhim ndertimi |
| 33. Armand Vokshi | Prof.as.dr. | Fakulteti i Arkitektures dhe Urbanistikës | Departamenti i Arkitetktures | Arkitekture ne turizem, restaurim monumentesh, |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Universiteti Politeknik i Tiranës | | menexhim ndertimi |
| 34. Elfrida Aliu | Prof.as.dr. | Fakulteti i Inxhinierise ne Ndertimit, Universiteti Politeknik i Tiranes | ZvRektore e Universitetit Politeknik te Tiranes | Inxhinieri ndertimi dhe menexhim i ndertimeve turistike |
| 35. Betim Cico | Prof.dr. | Fakulteti i Shkencave kompjuterike,Universitei Metropolitan i Tiranes | Fakulteti i Shkencave kompjuterike dhe IT | Teknologji informacioni |
| 36. Ahmet Ceni | Prof.dr. | Fakulteti i Ekonomise, Universiteti Metroplotian i Tiranes | Fakulteti i Ekonomise | Ekonomi, menexhim, tregu i punes |
| 37. Ozcan Asilkan | Prof.as.dr. | Fakulteti i Shkencave kompjuterike, Universiteti Metroplotian i Tiranes | Dekan i Fakultetit te Shkencave kompjuterike | Adminsitrim-Biznes, Shkenca kompjuterike, aplikime te programeve kompjuterike ne ekonomi |
| 38. Kristofor Lapa | Prof.as.dr. | Fakulteti i Shkencave Teknike, Universiteti i Vlores | Zv.Rektor i Universitetit te Vlores | Arikitektuar navale, shkencat teknike ,detaria dhe turizmi |
| 39 Elenica Pjero | Prof.as.dr. | Fakulteti i Ekonomise, Universiteti i Vlores | Departamenti i Administrim-Biznesit | Marketing, Sjellje konsumatore, ekonomiks turizmi |
| 40. Elona Proko | Prof.as.dr. | Fakulteti i Ekonomise, Universiteti i Vlores | Pergjegjese e Departamentit te Shkencave kompjuterike | Softe te aplikuara ne ekonomi dhe turizme |
| 41. Enkeled Mehilli | PhD (Greqi) | Fakulteti i Shendetit Publik, Universiteti i Vlores | Zv.rektor i Universitetit te Vlores | Menexhim shendetesor, ekonomiksi i shendetit |
| 42. Elton Domnori | PhD (Itali) | Fakulteti i Inxhinierise dhe IT, Universiteti Metropolitan i Tiranes | ZvDekani i Fakultetit te inxhinierise dhe IT | Softe te aplikuara ne ekonomi dhe turizem |

**Personalitet e spikatura që do të angazhohen në programin e Doktoraturës në Turizëm të Qëndrueshëm si key note speakers do të jenë nga marrëveshjet që ka UNISHK me Universitetet partnere si me poshtë:**

1. Prof.as.dr.Jasna Potocnik – Universiteti i Mariborit
2. Prof.dr.Marko Koscak – Universiteti i Mariborit
3. Prof.as.dr.Mirjeta Beqiri – Universiteti i Gonzagës, SHBA
4. Prof.dr.Ted Oelfke – Kolegji i Sandhills, SHBA

5. Prof.dr.Victoria Collins – Kolegji i Sandhills, SHBA
6. Prof.dr. Kirk Lynch – Kolegji i Sandhills, SHBA

**- Numri i personelit ndihmës akademik me karakter mësimor në funksion të programit të studimit.**

1. Znj.Fatbardha Myrtja - sekretare
2. Z.Gjovalin Deda – Laborant
3. Z.Virtyt Bushati – IT specialist

**- Nëse programi i propozuar është inter-disiplinor identifikoni personelin akademik që vjen nga departamente apo fakultete të tjera të UNISHK:.**

1. Prof.dr.Adem Bekteshi ( Fakulteti i Shkencave Natyrore)
2. Prof.dr.Gezim Dibra ( Fakulteti i Shkencave te Edukimit)
3. Prof.dr.Anila Neziri ( Fakulteti i Shkencave Natyrore)
4. Prof.as.dr.Marash Rakaj ( Fakulteti i Shkencave Natyrore)
5. Prof.as.dr.Nevila Dibra ( Fakulteti i Shkencave Shoqërore)
6. Prof.as.dr.Entela Hoxhaj ( Fakulteti Juridik)
7. Prof.as.dr.Alma Hafizi ( Fakulteti i Gjuhëve te Huaja)
8. Prof.as.dr.Dhurata Hoxha ( Fakulteti i Gjuhëve te Huaja)
9. Prof.as.dr.Edlira Bushati ( Fakulteti i Gjuhëve te Huaja)
10. Prof.as.dr.Meri Guli (Fakulteti i Gjuhëve te Huaja)

**c) Infrastruktura akademike në funksion të programit**

Fakulteti Ekonomik ofron mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e mësimit dhe organizimin e aktiviteteve mësimore dhe atyre me natyre kërkimore. Infrastruktura e fakultetit Ekonomik përfshin godinën e re të këtij fakulteti. Në godinën e fakultetit janë vendosur tre departamentet, zyra e dekanit dhe zv / dekanit, sekretaria e dekanit, sekretaritë mësimore, mjedise për personelin e mirëmbajtjes dhe ato sanitare, auditoret për mësim – leksione dhe seminare. Në godinën e Fakultetit Ekonomik janë dy laboratore të pajisur me kompjutera, me internet dhe të aksesueshme për të gjithë stafin akademik dhe studentët e Fakultetit Ekonomik. Gjithashtu në këtë godinë është e vendosur edhe Salla e Video Konferencave si dhe Qendra e Teknikës Mësimore të cilat gjithashtu janë të aksesueshme për të gjitha veprimtaritë e Fakultetit Ekonomik. Në dispozicion të programit të doktoraturës do të vihet gjithashtu edhe Salla e Asamblesë së Fakultetit Ekonomik e pajisur me smart board dhe video projektor. Gjithashtu Universiteti i Shkodrës ka Bibliotekën e vet modern, funksionale që në vitin 2007 me mbi 200 tituj librash të fushës së ekonomisë dhe kryesisht literaturë amerikane. Kjo bibliotekë me literaturën që ofron dhe ambjentet moderne ( 4 salla leximi dhe 2 salla kerkimi shkencor) në shërbim të studentëve të doktoraturës do të plotësojë më së mirë infrastrukturën në shërbim të këtij programi. Të gjitha sallat e zhvillimit të mësimit dhe laboratoret janë të pajisura me me video projektore dhe tabela projektimi. Sipërfaqja në total për realizimin e proçesit mësimor nga Fakulteti Ekonomik është **3199.4 m$^2$**.

| Mjedise për fakultetin/përgjegjës për programin e studimit | Sasia |
|---|---|

| | |
|---|---|
| Salla për leksione | 3 |
| Klasa për seminare | 11 |
| Salla për aktivitete promovuese (Auditori A1) | 1 |
| Salla për praktikë lëndore/ profesionale | - |
| Laboratorë | 2 |
| | |

Gjithashtu Universiteti i Shkodrës ka Bibliotekën e vet moderne, funksionale që në vitin 2007 me mbi 200 tituj librash të fushës së ekonomisë dhe kryesisht literaturë amerikane. Kjo bibliotekë me literaturën që ofron dhe ambjentet moderne ( 4 salla leximi dhe 2 salla kerkimi shkencor) në shërbim të studentëve të doktoraturës do të plotësojë më së mirë infrastrukturën në shërbim të këtij programi.

**e) Programet e Përbashkët**

**Ky seksion plotësohet vetëm nëse programi i propozuar ofrohet në bashkëpunim me një institucion tjetër duke përfshirë edhe një përshkrim të nivelit të bashkëpunimit, duke ju përgjigjur elementëve të mëposhtëm:**

- **Burimet financiare.**
- **Kontributi i partnerëve.**
- **Vënia në dispozicion e burimeve nga partnerët.**
- **Administrimi i programit.**
- **Lëshimi i diplomës dhe lloji (diplomë e përbashkët/ e dyfishtë/e shumëfishtë)**
- **Të dhëna mbi aktin e themelimit/licencimit të institucionit partner në vendin e origjinës.**
- **Të dhëna mbi aktin e akreditimit të institucionit partner ose të programit të studimit**
- **Dokument zyrtar bashkëpunimi mes palëve, marrëveshja kuadër.**
- **Marrëveshja specifike për programin konkret të studimit.**

Programi i doktoraturës në Ekonomi dhe Turizëm të Qëndrueshëm do të hapet ne Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Shkodrës në kuadër të projektit Erasmus + MARDS me titull "Reformimi i studimeve doktorale ne Mal te Zi dhe Shqiperi – paradigma e praktikes se mire" me numër 598465-EPP-1-2018-1-ME-EPPKA2-CBHE-SP, Marrëveshje nr. 210 prot. datë 21.01.2019 që Universiteti i Shkodrës ka nënështruar me Universitetin e Malit të Zi. Universitetet Partnere si Universiteti i Malit të Zi, Universiteti i Mariborit, Universiteti Politeknik i Tiranes, Universiteti i Vlorës, Universiteti Metropolitan i Tiranës, do të kontribuojnë me stafet akademike në mësimdhënie dhe supervizimin në kërkimin shkencor të kandidatëve të doktoraturës si dhe me vënien në dispozicion të infrasturkturë së tyre mësimore dhe kërkimore. Burimi financiar i këtij angazhimi të stafeve akademike do të mbështetet nga projekti MARDS, komuniteti i biznesit dhe të ardhurat e UNISHK nga aplikime në grantet e kërkimit shkencor. Po kështu të ftuart si key note speakers si Prof.as.dr.Mirjeta Beqiri Universiteti i Gonzagës, SHBA, Prof.dr.Ted Oelfke – Kolegji i Sandhills, SHBA, Prof.dr.Victoria Collins – Kolegji i Sandhills, SHBA do të mbështeten financiarisht nga burimet e dyanshme të universiteteve që mbi bazën e marrëveshjeve specifike i kanë përcaktuar rregullat përkatëse dhe reciproke.

Diploma që do lëshohet do të jetë e përbashkët dhe firmosja nga Rektorët e Universiteteve partnere në projektin MARDS do të përcaktohet mbi bazën e marrëveshjeve specifike.

**f) Analizë e tregut të punës**

**Në këtë seksion duhet të parashtrohet rezultati i studimit të tregut të punës për fushën përkatëse dhe ndërlidhja e programit të propozuar me trendin dhe nevojat e tregut të punës vendas dhe atij rajonal.**

**- Trendi vendas dhe rajonal i punësimit në sektorin ku bënë pjesë programi i studimit, referuar burime zyrtare si INSTAT, Ministria re Financës dhe Ekonomisë, organizma ndërkombëtar etj.**

**- Punësimi potencial i studentëve.**

**- Marrëveshje/kërkesa paraprake nga operator privat/institucione publike për punësimin eventual të studentëve pas diplomimit.**

# Analizë e tregut të punës

Kontributi i drejtpërdrejtë i sektorit të turizmit dhe udhëtimit të Shqipërisë në ekonominë e vendit pritet të rritet në 9.3% deri në vitin 2028, nga në 8.5% në 2017, sipas Këshillit Botëror të Udhëtimit dhe Turizmit (WTTC).

Sektori i turizmit dhe udhëtimit në Shqipëri kontribuoi drejtpërdrejt 134.1 miliardë lekë (1.25 miliardë dollarë / 1,02 miliardë euro) në ekonominë e vendit në vitin 2017, sipas WTTC në raportin e saj të Ndikimit Ekonomik të Udhëtimit dhe Turizmit, mbi Shqipërinë per vitin 2018.

Sipas parashikimit afatgjatë të këshillit, në vitin 2028 industria turistike do të gjenerojë 220.4 miliardë lekë.

Investimet në sektorin turistik parashikohet të rriten me 5.5% në 2018 nga 32.2 miliardë lekë në 2017. WTTC pret që investimet totale turistike dhe të udhëtimit të arrijnë gradualisht 52.1 miliardë lekë në 2028.

Në vitin 2017, industria turistike mbështeti drejtpërdrejt 93.500 vende pune, ndërsa në vitin 2020 WTTC projekton që ky numër të rritet me 3.3%. Sipas raportit, vendet e punës të mbështetura nga turizmi do të arrijnë gjithsej 111,000 në 2028

Në vitin 2023, Shqipëria pritet të tërheqë 4.85 milion turistë të huaj, ndërsa deri në vitin 2028 numri vjetor i mbërritjeve ndërkombëtare është parashikuar të arrijë në 6.6 milion.

WTTC rendit Shqipërinë e 30-të nga 135 vendet për sa i përket kontributit të drejtpërdrejtë të sektorit ndaj PBB së në 2017, e llogaritur si përqindje. Për krahasim, turizmi në dy destinacionet e tjera turistike të Ballkanit Perëndimor, Mali i Zi dhe Kroacia, kontribuan vitin e kaluar 11% dhe 10.9%, përkatësisht, në PBB-në e ketyre vendeve.

Sipas vleresimit të Komisionit Europian në dokumentin e Programit të Reformës Ekonomike për Shqipërinë (Brussels, 11.4.2019 SWD -2019 -166 final) sfida kryesore mbetet sigurimi i zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të turizmit. Shqipëria ka potencialin për t'u bërë një destinacion i rëndësishëm turistik në Evropë, por sektori mbetet me plot sfida. Sektori i turizmit në Shqipëri është shfaqur si një kontribues domethënës i rritjes me gati 6 milion turistë hyrëse në 2018 krahasuar me 4 milion në 2015 (4.7 milion në 2016, 5.1 milion në 2017) dhe gjeneroi në mënyrë direkte në 8.5% të PPK-së në 2017. Sektori, së bashku me shërbimet satelitore,

kontribuan rreth 26.2% në PPK dhe 24.1% në punësimin e përgjithshëm. Në vitin 2016, udhëtimi dhe turizmi mbështetën drejtpërdrejt 85.500 vende pune (7.7% e punësimit në total), por kjo pritet të rritet me rreth 3% në vit për të arritur në 120,000 vende pune ose 10.1% e punësimit të përgjithshëm në 2027 (ËTTC, 2016). Në të vërtetë, sektori i turizmit mund të ketë një efekt shumëfishues në punësim përmes shërbimeve anësore dhe sektorëve të lidhur.
Mbi bazën e anketave të kryer nga STATISTA numri i të punësuarve sipas industrive turistike ka ardhur duke u rritur gjatë periudhës 2014 – 2016 sipas Tabeles 1:

**Tabela 1: Numri i të punësuarve në industritë turistike ( të dhënat janë në mijëra)**

| INDUSTRITË TURISTIKE/VITET | 2014 | 2015 | 2016 |
|---|---|---|---|
| **Akomodimi (Hotelet,** | 19.4 | 21.8 | 30.1 |
| **Transporti i pasagjerëve** | 6.2 | 6.2 | 7.8 |
| **Agjensitë e udhëtimeve dhe shërbimet e rezervimit** | 1.1 | 1 | 1.6 |

Në Rajonin e Veriut të Shqipërisë (Qarku Shkodër, Qarku Kukës, Qarku Lezhë) bujqësia përbën sektorin kryesor mbështetës të ekonomisë duke vijuar më tej me sektorin e turizmit, tregtisë, shërbimeve dhe në nivele më të ulëta në industri (miniera, industri ushqimore, kimike, etj). Sektori i bujqësisë, kontribuon me 34% në normën e punësimit të Rajonit ndërkohë që sektorët e tjerë si turizmi dhe shërbimet luhaten në norma prej 11% deri në 13,6% ( Burimi Agjensia e Zhvillimit Rajonal 1).
Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018 rezulton se numri i të punësuarve në Bashkinë Shkodër është 26,980 persona, nga të cilat 7,576 punonjës janë të punësuar në sektorin publik dhe 19,404 punonjës në sektorin privat. Numri më i madh i të punësuarve është në qytetin Shkodër, ndjekur nga Njësia Administrative Rrethina.
Në mënyrë specifike në kuadër të këtij aplikimi u realizua një studim i tregut të punës duke analizuar ofertën e bizneseve të Veriut të Shqipërisë.
Në këtë studim informacioni primar është mbledhur nëpërmjet pyetësorëve në secilën prej zonave të marra në studim si dhe intervistat më specialistë dhe persona që ndodhet në organet e pushtetit lokal, zyrat e punësimit në Shkodër, Pukë, Lezhë dhe Kukës. Madhësitë e mostrave janë zgjedhur në raport të përafërt me popullsinë e zonave ashtu edhe me rëndësine e subjekteve të interesit të veçantë për studimin. Pyetësorët e realizuar sipas zonave jepen si më poshtë.

**Tabela 2.1. Të dhëna mbi survejimin e studimit, 2019**

| Emri i Zonës | Pyetësor për banorët | Pyetësor për studentët | Intervista me Ekspertët | Totali |
|---|---|---|---|---|

| | Totali: Të përgjithshme (1 ) | Pyetësor për bizneset (2 ) | (3) | (4) | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Shkodër** | 250 | 180 | 70 | 11 | 511 |
| **Pukë** | 60 | 25 | 15 | 1 | 101 |
| **Kukës** | 120 | 50 | 25 | 2 | 197 |
| **Lezhë** | 185 | 85 | 28 | 1 | 299 |
| **Totali** | **615** | **340** | **138** | **15** | **(1)+(3) + (4)=1108** |

Mostra e përdorur për këtë pyetësor është mostra e rastësishme dhe ka këto karakteristika:

**Grafiku 1.1.**




**Grafiku 1.2.**




**Grafiku 1.3.**




**Pyetja: Cili sektor i ekonomisë ka zhvillimin më të madh aktual në zonën tuaj?**

**Grafiku 1.4. Sektorët ekonomik aktualisht më të zhvilluar**




Pra siç shihet edhe nga rezultatet e anketimit sektori më i zhvilluar në Rajonin e Veriut të Shqipërisë del të jetë tregtia me 49 % rezultat ky që përputhet afërsisht edhe me bizneset e rregjistruara në Zyrën e Tatim-Taksave në Shkodër ku për bizneset e vogla rreth 35% janë biznese të tregtisë me pakicë të artikujve të ndryshëm dhe për bizneset e mëdha 37 % e përbëjnë kryesisht tregtia me shumicë dhe tregtia e karburantit. Tregtia është pasuar nga artizanati dhe blegtoria ku për këtë të fundit dihet se Shkodra është e rrethuar nga fshatra me tradita në blegtori ku historikisht rendimentet në qumësht, vezë ka qenë ndër më të larta në Republikë..

**Pyetja: Cili sektor do të ishte prioritar për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të zones tuaj?**
***Shënoni me një numër për secilin sektor nga: 1.aspak prioritar deri tek 5.shumë prioritar.***

**Grafiku 1.5. Sektorët prioritar të zhvillimit ekonomik**




Përsa i përket të ardhmes ekonomike të Rajonit të Veriut të Shqipërisë të anketuarit në pjesën më të madhe të tyre mendojnë se duhet të jetë tregtia e pasuar nga peshkimi dhe turizmi. Përsa i përket tregtisë kemi trajtuar edhe më sipër traditat në fushën e tregtisë të shkodranëve me një histori më shumë se 100 vjeçare në këtë sektor (Shkodra e 3550 dyqaneve të vitit '70 të shek XIX). Në fakt mendojmë se ky përfundim i anketimit përsa i përket tregtisë është shumë i bazuar në zhvillimin aktual të ekonomisë së Rajonit pasi qytete te veçanta ka mundësi të mëdha për zhvillimin edhe të degëve të industrisë me tradita si ajo e tekstileve, ushqimore, energjitike, e drurit, ndërtimit.

**Pyetja: Kush duhet të mbështesë bizneset ne zonen tuaj?**

*Shënoni me një numër për secilën alternativë nga: 1.aspak prioritar deri tek 5.shumë prioritar.*

**Grafiku 1.6. Mbështetësit kryesor të biznesit**




Siç shihet edhe nga grafiku rreth 36% e të anketuarve mendojnë se bizneset duhet të mbështeten nga individi duke u pasuar një përqindje të afërt prej 29% me emigrantët ku dy faktorë që aktualisht kanë rolin përoaktues në investimet dhe zhvillimet e ekonomisë së gjithë Rajonit të Shkodrës Dhe po kështu e mendojmë edhe në të ardhmen banoret e Rajonit te Veriut zhvillimet e bizneseve të tyre por natyrisht duke mos lënë pas dore mbështetejen nag shteti në masën prej 21% ku dihet roli itij aktualisht duhet të jetë më i madh në fushën e infrastrukturës në ndihmë të bizneseve.

**Pyetja: Rendisni tre problemet kryesore që favorizojnë zhvillimin ekonomik te zonës tuaj?**

**Grafiku 1.7.Problemet që favorizojnë zhvillimin ekonomik**




Siç shihet edhe nga grafiku është e natyrshme që pjesa më e madhe e të anketuarve mendojnë se favorizuese për zhvillimin ekonomik të Shkodrës është pozicioni gjeografik duke qenë 2 orë larg nga kryeqyteti i Shqipërisë dhe 1 orë larg nga kryeqyteti i Malit të Zi (rrugë liqenore edhe më e shkurtër).

Në masën 38% të anketuarit mendojnë se zhvillimin ekonomik të sotëm e favorizon zhvillimi aktual i biznesit i cili siç e përmendëm më sipër mbështetet kryesisht nga emigracioni. Është shpirti i iniciativës së lirë të banorëve që aktualisht udhëheqin rreth 2000 biznese të vogla dhe 700 biznese të mëdha. Është në sajë të këtij investimi privat që rreth 80 000 turiste aktualisht kalojnë pushimet në fshatin turistik të Velipojës, i cili mund të merret si model i zhvillimit të turizmit me një ndërhyrje minimale të qeverisjes vendore dhe qëndrore.

**Pyetja: Rendisni tre problemet kryesore që pengojnë zhvillimin ekonomik të zonës tuaj?**

**Grafiku1.8. Problemet që pengojnë zhvillimin ekonomik**




Kësaj pyetjeje rreth 47% e të anketuarve i janë përgjigjur se zhvillimi ekonomik i zonës pengohet nga infrastruktuar e dobët - një rezultat ky që ka përputhje të plotë me realitetin.

Megjithatë vlerësohen potencialet e qyteteve si Shkodra, Kukësi, Lezha dhe Puka në zhvillimin e turizmit. Në mnëyrë të veçantë Bashkia Shkodër ka mundësi në zhvillimin e 4 llojeve kryesore të turizmit:

1) **Turizmi qytetar** i përfaqësuar nga qyteti i Shkodrës me 90 monumentet e kulturës dhe shtëpiat e saj karakteristike;

2) **Turizmi malor** i përfaqësuar nga zona Razëm-Bogë –Theth;

3) **Turizmi bregdetar** i përfaqësuar nga Velipoja, Baks Rrjolli dhe

4) **Turizmi Liqenor** i përfaqësuar nga Liqeni me i madh i Ballkanit dhe zona e Shirokës dhe Zogaj

Bashkia Lezhë në zhvillimin e turizmit qyetar e kulturor me monumentet e kulturës dhe turizmin bregdetar me zonën e Shëngjinit

Bashkia Kukës me turizmin qytetar dhe malor. Bashkia Pukë e përfaqësuar me artizanatin dhe turizmin malor.

## Popullsia Qarku Shkodër

Të dhenat demografike të INSTAT për Qarkun e Shkodrës të vitit 2016, regjistrojnë 205 mije banore, nga të cilet janë të grupuar 18% në grupmoshen 0-14, 69% në grupmoshen 15 64 dhe 13% sipër 65 vjeç. Në një dekade ka një renie prej 30 mije banoresh, trend negativ vjetor -1.5%, në linjë me trendin kombetar në përgjithesi; nga 2008 deri në 2018 ka renie popullsie në Shqipëri me 111 mije njësi.

**Tabela 1 - Demografia**

| Shkodër | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Total | 235667 | 232013 | 229140 | 225549 | 222611 | 219548 | 216477 | 213148 | 210168 | 207924 | 204994 |
| Δ Njësi | -4083 | -3654 | -2873 | -3591 | -2938 | -3063 | -3071 | -3329 | -2980 | -2244 | -2930 |
| Δ Përqindje | -1.7% | -1.6% | -1.2% | -1.6% | -1.3% | -1.4% | -1.4% | -1.5% | -1.4% | -1.1% | -1.4% |

Të punësuarit në sektorin privat jo-bujqësor në 2016 janë 19 114 njësi , ose 13 3% e njerezve në moshe punë 15-65 vjeç dhe teorikisht të aftë për punë, duke e renditur qarkun e Shkodres në vendin e pestë pas Tiranës - 40%, Durresit - 23 7%, Vlores - 16.3%, Gjirokastres 14.4% 1 .
Si tregues për angazhimin e të rinjve në tregun e punës kemi zgjedhur të përdorim shkallen e punësimit 2 në vend të shkalles se papunësise 3 , sepse në gjykimin tonë e para është me treguese.
Sipas të dhenave INSTAT 4 , gjatë tremujorit të parë të vitit 2018, shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 59,2 % (burrat – 66,5%, gratë – 51.9%); shkalla e punësimit të të rinjve, mosha 16 – 29 vjeç, është 35,9%.
Në qarkun Shkoder shkalla e punësimit është pak me lart se mesatarja kombetare, 61,6%.

**Analiza Strukturës Ekonomike në Qarkun Shkodër**

1 INSTAT, Të dhëna administrative 2016
2 Shkalla e punësimit është raporti i të punësuarve 15-64 vjeç kundrejt popullsisë në moshë pune
3 Shkalla e papunësisë është raporti i të papunëve kundrejt forcës së punës
4 INSTAT, Ankota Tremujore e Forcave të Punës Tremujori I 2018

Qarku Shkodër në shkallë vendi zë: vendin e parë në prodhimin e energjisë elektrike, vendin e dytë në prodhimin e industrisë së drurit, vendin e tretë në prodhimin bujqësor 5 Ndër aktivitete ekonomike kryesore renditen:
- bizneset prodhuese; në përgjithesi janë fasonistë (lëkurë, këpucë dhe konfeksione), prodhim kabllo elektrike, përpunim druri, prodhime sallamerie, etj
- përpunimi i lëndës drusore për ndërtim, mobilieri etj
- aktiviteti i ndërtimit të rrugëve, urave, pallateve të banimit (prodhim materiale ndertimi, tulla asfalt-beton, përpunim inerte)

- aktiviteti bujqësor/blegtoral zë një peshë të rëndësishme në ekonominë e qarkut. Produktet kryesore bujqësore janë misri, gruri, elbi, patatja dhe domatet, perimet, frutat, dhe në blegtori mishin e lopës, deles, dhisë, derrit, pulës, qumështin,vezët dhe leshi
- aktivitetet e përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale (konserva te frutave, perimeve, peshkut, mishit, embelsira, përpunim bimeve medicinale)
- punimet e ndryshme artistike të traditës (gdhendje në gur, dru, metal)
- aktivitetet turistike të cilat përfshijnë ekskursione, vizita ditore dhe afatgjata

## Te dhëna mbi industrine HORECA ne rrethin Shkoder

| Njesia | Njesi Akomodimi | Restorante | Bare |
|---|---|---|---|
| Numri | 44 | 76 | 234 |

Njesite akomoduese ne fushen e turizmit ne rrethin e Shkodres, kane nje rritje prej 12% ne dy vitet e fundit, ne baze te te dhenave nga ministria e turizmit dhe mjedisit. Kjo rritje vjen si rrjedhoje e rritjes totale qe ka pase dhe Shqiperia ne numrin e turistave ne vitet e fundit. Mundesite kryesore qe studentat kane per punesim ne HORECA jane ne recepsion, menaxher, marketing, menaxhim konferencash tek njesite akomoduese dhe menaxher dhe marketues ne restorantet dhe baret e mira ne qytet.
Nga intervistat dhe takimet direkte qe jane bere me bizneset e rrethit Shkodër u vune re problemet e me poshte ne lidhje me punesimin:
5 Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Shkodër, Guidë Qarku Shkodër 2009

1. Ankohet qe studentat vine pa eksperienca dhe trainime ekstra nga universiteti
2. Nuk kane mbeshtetje nga zyra e punesimit per sigurimin e praktikanteve
3. Mungon gjuha e huaj e folur rrjedhshem nga studentat
4. Ka mungese per guzhiniera, kamariera, studenta qe kane njohuri nga marketing dixhital, guidator turesh si dhe mungon kreativiteti dhe krijimi i startupeve

Këto jane disa nga problemet që bizneset në fushen e turizmit kanë hasur. Nderkohe bizneset nga ana tjeter kanë nevojë për kërkime tregu sidomos ne aspektin e trendeve dhe nevojës per shtreter ne vitet qe vine. Po hapen hotele te reja por pa nje analize te mirefillte mbi nevojen per burime njerzore dhe kerkesen qe do kete tregu ne 10 vitet e ardhshme per dhoma. Si dhe bizneset kerkojne me shume mbeshtjetje nga qeverisja locale ne krijimin e DMOve, dhe perfaqesimit me te madh per promovimin e qytetit dhe krijimin e eventeve qe do ndikonin me shume ne thithjen e turistave.

**Analiza e Pyetësoreve drejtuar studentëve**

Për Studimin e Tregut të Punës të studentëve të diplomuar pranë Fakultetit Ekonomik është përgatitur një pyetësor i cili është shpërndarë online në adresat e emaileve të studentëve në dy programet e studimit Bachelor dhe Master, ne Turizëm. Ky pyetësor është shpërndarë në dy faza. Në të dy fazat këtij pyetësori u janë përgjigjur gjithsej 48 studenta te turizmit. Analiza e rezultateve të këtij pyetësori është më së shumti bazuar mbi këtë periudhë 4 vjeçare kohore të

studentëve mbas diplomimit të tyre Me poshte eshte dhe nje permbledhje e pergjithshme.
Pyetesorit I jane pergjigjur 21 studente femra ose 45 % dhe pjesa tjeter per 55 % meshkuj. 60 % e studentave jane nga qyteti Shkoder dhe pjesa tjeter nga rrethet.
Rreth 30% e studentëve të përgjigjur kanë mbaruar vetëm programin e studimit Bachelor, 25% e tyre janë duke vazhduar studimet në programin Master, 40% e tyre kanë kryer ciklin e dytë të studimeve Master dhe 5% janë në process doktorature.
Një faktor ndikues dhe i rëndësishëm i kërkimit punë- në tregun e punës, është edhe niveli i të ardhurave familjare i cili varion sipas shkallëve të ndryshme të paraqitura në Tabelën e mëposhtme.

**Tabela 1**

| **Niveli i të Ardhurave Familjare (në %)** | |
|---|---|
| Më pak se 50,000lek/muaj | 15% |
| 50 - 100,000Lek/muaj | 45% |
| 100 -150,000Lek/muaj | 5% |
| 150 - 200,000Lek/muaj | 2% |
| Më shumë se 200,000Lek/muaj | 0 |
| Nuk preferoj të përgjigjem | 25.00% |

Statusi aktual në tregun e punës rezulton të 45% të papunë dhe 50% të punësuar nga të cilët 5% janë të vetëpunësuar.
Ndër arsyet kryesore që studentët listojnë për mosgjetjen punë janë më së shumti mungesa e eksperiencës kërkuar nga punëdhënësit në 15% të rasteve dhe vetëm 5% ofertë të lartë të diplomuarve në tregun e punës. Gati 45 % e studentave nuk i jane pergjigjur kesaj pyetje.

**Tabela 2**

| **Arsyet kryesore që nuk keni gjetur punë aktualisht?** | **%** |
|---|---|
| Kërkesë eksperience pune nga punëdhënësit | 15 |
| Kërkesë e vogël për vende pune nga ana e firmave. | 10 |
| Ofertë e lartë e të diplomuarve në tregun e punës. | 5 |
| Mungesa e informacionit për vende të lira pune dhe jo-efektiviteti i institucioneve të tilla si qendrat e punësimit, zyra e punës, etj. | 10 |
| Mospërshtatje të punës së ofruar me kërkesat apo preferencat tuaja individuale | 5 |
| Interesa të tjera tuaja si p.sh. rritja e fëmijëve në shtëpi, kujdesi ndaj të moshuarve, etj. | 10 |

Nga ana tjeter ne diskutimet e ndryshme me stduentat eshte vene re mungesa e motivimit per te aplikuar per pune fushen e turizmit si rrjedhoje e pikave te meposhtme:
1 Pagesa te ulta
2 Mungese te diteve te pushimit
3. Mos sigurimi nga ana e punonjesve ne punet sezonale
4. Nuk shohin rritje ne karriere

**PYETËSOR**

Ky pyetësor është ndërtuar për analizën e **Studimit të Tregut të Punës** të studentëve që kanë mbaruar studimet pranë Fakultetit Ekonomik, Shkoder
*Faleminderit per kohen tuaj.*

**SEKSIONI 1 - Të Përgjithshme**

1. **Mosha juaj:**

________

2. **Gjinia:**
- Mashkull
- Femër

3. **Qyteti i lindjes:**

________

4. **Qyteti ku banoni aktualisht:**

5. **Statusi aktual civil:**
- Beqar
- Martuar

6. **Edukimi juaj më i lartë arsimor:**
- Bachelor
- Master
- Duke ndjekur studimet Master
- Duke ndjekur studimet Doktorature

7. **Dega Bachelor e arsimimit tuaj:**
- Turizem
- Administrim Biznes
- Finance Kontabilitet

8. **Viti i diplomimit Bachelor:**

9. **Mesatarja juaj në programin Bachelor:**
- 5 – 6
- 6 7
- 7 8
- 8 9
- 9 – 10

10. **Niveli i të ardhurave neto mujore në familjen tuaj (opsionale):**

- më pak se 50,000lek/muaj
- 50-100,000Lek/muaj
- 100-150,000Lek/muaj
- 150-200,000Lek/muaj
- më shumë se 200,000Lek/muaj
- nuk preferoj të përgjigjem

11. **Statusi juaj aktual në Tregun e Punës:**
- I papunë (shko tek Seksioni 2-I Papunë)
- I punësuar (shko tek Seksioni 3-I Punësuar)
- I vetëpunësuar (shko tek Seksioni 4-I Punësuar dhe Vetëpunësuar)

**SEKSIONI 2 – I Papunë**

12. **Nëse aktualisht jeni i papunë, keni punuar ndonjëherë?**
- Po
- Jo

13. **Nëse keni punuar, sa kohë keni punuar?**
- Nuk kam punuar
- Me pak se 1vit
- 1 2 vite
- 2-3 vite
- Më shumë se 3 vite

14. **Cila mendoni se është arsyeja që nuk keni gjetur punë?**

- Kërkesë e vogël për vende pune nga ana e firmave.
- Ofertë e lartë e të diplomuarve në tregun e punës.
- Mungesa e informacionit për vende të lira pune dhe jo-efektiviteti i institucioneve të tilla si qendrat e punësimit, zyra e punës, etj.
- Mospërshtatje të punës së ofruar me kërkesat apo preferencat tuaja individuale.
- Interesa të ardhshme në sipërmarrje personale në sektorin privat
- Interesa të tjera tuaja si p.sh. rritja e fëmijëve në shtëpi, kujdesi ndaj të moshuarve, etj.

15. **A mendoni se Arsimimi juaj do të jetë i dobishëm në të ardhmen për të gjetur punën që dëshironi?**
- Aspak
- Pak
- Mjaftueshem
- Shumë

16. **A do të migronit në qytete të tjera brënda Shqipërisë për të gjetur punë?**
- Po
- Jo

17. **A do të emigronit jashtë Shqipërisë për të gjetur punë?**
- Po
- Jo

SEKSIONI 3 – I Punësuar

**18. Sektori ku jeni i punësuar?**
- Në sektorin publik
- Në sektorin privat
- Organizata jo Fitimprurëse

**19. Në çfarë mënyre jeni vënë në dijeni për këtë vend pune?**
- Lajmerime te shpallura në media të ndryshme
- Njohje personale
- Nëpermjet marrëdhënieve shoqërore

**20. A keni një kontrate të rregullt pune?**
- Kontratë të përhershme
- Kontratë të përkohshme
- Marrëdhënie pune e rastësishme

**SEKSIONI 4 - I Punësuar dhe I Vetëpunësuar**

**21. Qyteti ku jeni i punësuar aktualisht:**

________

**22. Mbas mbarimit të studimeve, sa gjatë keni pritur para se të filloni punë?**
- Me pak se 1vit
- 1-2 vite
- 2-3 vite
- Më shumë se 3 vite

**23. Në çfarë sektori të ekonomisë punoni?**
- Bujqësi,
- Peshkim
- Industri nxjerrëse
- Industri përpunuese
- Industria e energjise, ujit
- Ndërtim
- Tregti, Shërbime
- Hoteleri, restorante
- Transport, komunikacion
- Arsim
- Shëndetësi
- Tjeter__________

**24. Cili është profesioni juaj?**
- Ligjvënës, nëpunës të lartë të administratës shtetërore dhe drejtor ekzekutiv
- Profesionistë të nivelit të lartë
- Teknikë dhe specialistë në zbatim
- Nëpunës zyre, asistent
- Punonjës të shërbimeve dhe shitjeve
- Punonjës të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit
- Zejtarë, artizanë dhe profesione të lidhura me ato
- Punonjës të montimit dhe përdorimit të makinerive dhe pajisjeve
- Punëtorë (profesione elementare)

- Tjetër___________

**25. Cili është niveli i pagës suaj bruto mujore (opsionale)?**

- Me pak se 30,000lek
- 30-50,000lek
- 50-80,000lek
- Më shumë 80,000lek
- Nuk preferoj të përgjigjem

**26. Sa i kënaqur jeni me punën tuaj?**

- Aspak
- Pak
- Mjaftueshëm
- Shumë

**27. Sa përputhet profili i arsimimit tuaj me punësimin tuaj aktual (qarkoni)?**

1 2 3 4 5

**28. A mendoni se Arsimimi juaj ka qenë i dobishëm për të gjetur punën që dëshironi (qarkoni)?**

1 2 3 4 5

**29. Pse mendoni se nuk është e lehtë të gjesh punën e dëshiruar?**

- Sistemi botëror në krizë ekonomike
- Sistemi shqiptar në krizë ekonomike
- Nuk ka planifikim të numrit dhe llojeve të profesioneve të nevojshme për zhvillimin (psh zhdukja e zanateve dhe tepricë te diplomuarish në degë të caktuara)
- Refuzimi i të rinjve për punën në pergjithësi
- Mungon specializimi ose eksperienca individuale e duhur
- Joefektiviteti i institucioneve të tilla si Qendrat e Punës, etj.
- Tjetër________

- Tjetër________